

VENDIM
Nr.233, datë 7.4.2010

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.478, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fund të shkronjës “a” shtohet emërtesa “Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”.

b) Në shkronjën “b” të bëhet ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

i) Emërtesa “Instituti i Kurrikulave dhe Trajnimit”, shfuqizohet.

ii) Në fund të kësaj shkronje shtohen emërtesat “Instituti i Zhvillimit të Arsimit dhe Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar”.

2. Pagat e punonjësve të tjerë mbështetës të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të Institutit të Zhvillimit të Arsimit dhe të Inspektoratit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar të përcaktohen sipas vendimit për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore.

3. Efektet financiare, për vitin 2010, të përballohen nga fondet e planifikuara për këtë vit për sistemin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe për sistemin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data e emërimit të nëpunësve dhe të punonjësve në detyrë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha